

VENDIM
Nr.412, datë 11.7.2007

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PRONËS “GODINË 2-KATËSHE”, NGA AGJENCIA TELEGRAFIKE SHQIPTARE TE MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.444, DATË 16.6.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI AGJENCISË TELEGRAFIKE SHQIPTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit “Godinë 2-katëshe” nga Agjencia Telegrafike Shqiptare te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për dhënien në përdorim Unionit (Bashkimit) të Dhomave të Tregtisë, sipas planvendosjes dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Për pronën “Ndërtesa ekzistuese e ATSH-së”, me numër rendor 1, në formularin 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.444, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Agjencisë Telegrafike Shqiptare”, shfuqizohet pjesa “Sipërfaqe truall dhe sipërfaqe ndërtesë”, që, përkatësisht, i përket objektit “Godinë 2-katëshe”, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, drejtori i Agjencisë Telegrafike Shqiptare dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJICE Projekt VKM
HTR Godina e ATSH + godina 2 kt per kalim ne dministrim te METE



